




# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

## AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



|                        |                                                                                                                                                                                   |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 18.04.2018                                                                                                                                                                        |
| REFERENC-Ë:            | AKK- DPKPP /03-03-1145/18                                                                                                                                                         |
| PËR/ZA/TO:             | z. Adem DURIQI<br>Menaxher i zyrës së Prokurimit Komuna e Lipjanit                                                                                                                |
| CC:                    | z. Imri AHMETI<br>Kryetar i Komunës së Lipjanit                                                                                                                                   |
| NGA/OD/FROM:           | Shaip HAVOLLI<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit                                                                                                                          |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin me titull: <b>“Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit të Kombit Xhavit Kozhani”</b> me nr. të prokurimit 613/18/2113/521, nr. të brendshëm 613/018/022/521. |

*I nderuari z.DURIQI,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit të Kombit Xhavit Kozhani”** me nr. të prokurimit 613/18/2113/521, nr. të brendshëm 613/018/022/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

### OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit të Kombit Xhavit Kozhani”** me nr. të prokurimit 613/18/2113/521, nr. të brendshëm 613/018/022/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

### *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 13 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1145/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Renovimi i Lapidarit të Dëshmorit të Kombit Xhavit Kozhani”** me nr. të prokurimit 613/18/2113/521, nr. të brendshëm 613/018/022/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar 15,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që në njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar punë të ngjashme (njëjtë) në tri vitet e fundit në vlerë minimale 25,000.00€”* ndërsa tek dëshmia dokumentare është kërkuar: *“Lista e projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit për punë të ngjashme (njëjtë) dëshmuar me kopjet e referencave në 3 vitet e fundit në vlerën minimale prej 60,000.00€”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Gjatë analizimit të njoftimin për kontratë respektivisht të nenit III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional konkretisht kërkesën nr. 1, Agjencia ka vërejtur se kërkesa për punë të ngjashme (njëjta) në 3 (tri) vitet e fundit, me dëshminë dokumentare nuk janë identike njëra me tjetrën, për faktin se në kërkesë është cekur *vlerë minimale 25,000.00€*, kurse tek dëshmia dokumentare vlera minimale prej *60,000.00€*. Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se, kërkesa e specifikuar tek dëshmia e kërkuar dokumentare në nenin III.2.4. të njoftimit për kontratë, është në kundërshtim me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 26 paragrafi 8 pika 4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, ku thuhet: *Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë kufizimin ligjor një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.*

Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues duke vepruar në këtë mënyrë krijon konfuzion te operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar për të tenderuar në këtë aktivitet të prokurimit, lidhur me kërkesën në fjalë, a duhet të ofroj si dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar punë të ngjashme (njëjta) në tri vitet e fundit në vlerë minimale 25,000.00€ apo në vlerë minimale 60,000.00€.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shitesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*